

ABSTRAKT

MËNYRAT E FITIMIT TË DREJTËS SË PRONËSISË PËRMES TRASHËGIMISË, PROBLEMET PRAKTIKE

Kandidate: Blinere Beka

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri

Instituti i trashëgimisë përbën një instrument të rëndësishëm të së drejtës dhe studimi i saj sjell njohuri në nivelin akademik dhe në atë praktik. Në të njëjtën kohë e drejta në pronë është pjesë përbërëse e çdo sistemi ligjor, përfshirë edhe sistemin ligjor të Republikës së Kosovës, e cila e drejtë garantohet me aktin më të lartë të vendit- Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligje dhe akte të tjera nënligjore. E drejta e pronës mbrohet mbi bazën e disa akteve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë punim do të fokusohemi shkurtimisht në aspektet e të drejtës trashëgimore duke shpjeguar se çfarë trajton kjo e drejtë, elementet e saj thelbësore dhe rëndësinë që mbart në jetën juridike si dhe konceptet bazike të drejtës pronësore, mënyrat e fitimit të pronësisë dhe problemet praktike.

Trashëgimia është një nga mënyrat përmes së cilës fitohet pronësia. Elementi kryesor për fillimin e procedurës trashëgimore është vdekja e trashëgimlënësit në cilësinë e pronarit të pronës. Element tjetër i rëndësishëm është edhe transferimi i pronës nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët e para përcaktuar me Ligj ose testament.

Në anën tjetër e drejta e pronës konsiderohet e pacenueshme. Trajtimi juridik i konceptit të pasurisë dhe veçanërisht mbi mënyrat e fitimit të pronësisë, është në vetvete shumë i vështirë dhe problematik në nocion, pasi trajton një gamë të gjerë konceptesh, ndërthurje legjislacioni dhe institutesh. Pronësia, në përgjithësi e sidomos ajo mbi pasuritë e paluajtshme, tradicionalisht zë një vend të veçantë, në çdo sistem ligjor. Mbi të gjitha, siç demonstron nga përfshirja e tyre në akte ndërkombëtare, ajo rreshtohet si pjesë e të drejtave të njeriut që shtetet duhet të promovojnë dhe mbrojnë. Kjo temë trajton një nga mënyrat e fitimit të pronësisë, atë me anë të trashëgimit. Punimi trajtohet në disa këndvështrime. Pjesa e parë trajton çështjet kryesore që ndërlidhen më të

drejtën trashëgimore, si: kuptimi i trashëgimisë, trashëgimia ligjore, trashëgimia testamentare, përjashtimi nga e drejta e trashëgimit dhe realizimi i të drejtës së trashëgimisë.